



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 47
Prishtinë, më 19 prill 2017, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Bali Muharremaj, Abdyl Ymeri, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Munguan:

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit tjerë: Albulena Nuha nga RTV21, Uran Haxha nga Koha Ditore, Kaltrina Zymberi nga Ekonomi Online. Isamil Shabani nga Kosova Pres. Valbon Bytyçi, Bujar Bajraktari, Vlora Mehmeti, Mirlinda Ahmeti dhe Drilon Shala nga ZKA.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016. I ftuar ministri i MASHT-it, z. Arsim Bajrami;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit dhe Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore. I ftuar ministri i MASHT-it, z. Arsim Bajrami;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016

Faton Topalli, kryetar, theksoi se ministri MASHT, për shkak të agjendës së ngjeshur, ka kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të zhvendoset për javën e ardhshme.

Përfundim

KMFP, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit dhe Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore

Faton Topalli, kryetar, theksoi se ministri MASHT, për shkak të agjendës së ngjeshur ka kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të zhvendoset për javën e ardhshme.

Përfundim

KMFP vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

5. Të ndryshme.

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se Parlamenti Evropian ka organizuar një Konferencë, më 02-03 maj 2017, në Bruksel, lidhur me Prokurimin Publik dhe bashkëpunimi me Kuvendin. Me këtë rast kërkoi nga deputetët e pranishëm të caktohen dy deputetë nga KMFP-ja për të marrë pjesë në këtë Konferencë. Me këtë e hapi diskutimin.

Përfundim

KMFP, vendosi që në Bruksel në Konferencën për Prokurimin Publik dhe bashkëpunimi me Kuvendin më 2 dhe 3 maj 2017, do të marrin pjesë deputetët: Ali Sadriu dhe Abdyl Ymeri, ndërsa nga stafi i Komisionit do të marrë pjesë Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli